

VENDIM
Nr. 294, datë 20.4.2016

PËR MIRATIMIN E DOKUMENTIT TË NDRYSHIMIT TË MARRËVESHJES SË GRANTIT, TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 636, DATË 31.7.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË GRANTIT SUEDEZ, NR. TF014255, NDËRMJET SHQIPËRISË DHE BANKËS NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM (IBRD), QË VEPRON SI ADMINISTRATOR I FONDEVE GRANT TË SIGURUARA NGA SUEIDIA, E PËRFAQËSUAR NGA AGJENCIA SUEDEZE PËR BASHKËPUNIM DHE ZHVILLIM NDËRKOMBËTAR (SIDA), PËR BASHKËFINANCIMIN E PROJEKTIT TË BURIMEVE UJORE DHE UJITJES”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23, të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998, “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e dokumentit të ndryshimit të marrëveshjes së grantit, të miratuar me vendimin nr. 636, datë 31.7.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjes së grantit suedez nr. TF014255, ndërmjet Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), që vepron si administrator i fondeve grant të siguruara nga Suedia, e përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA), për bashkëfinancimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

Banka Botërore
BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM
DHE ZHVILLIM
SHOQATA NDËRKOMBËTARE PËR
ZHVILLIM

1818 H Street N.W. (202) 473-1000
Washington, D.C. 20433 Adresa kabllore: INTBAFRAD
SHBA Adresa kabllore: INDEVAS

_____, 2016

Sh.T.Z Shkëlqim Cani
Ministër i Financave
Ministria e Financave
Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”
Nr. 4, Tiranë
Republika e Shqipërisë

Lënda: Republika e Shqipërisë
Granti nr. TF014255 - Granti Suedez për Bashkëfinancimin e
Projekti për Burimet Ujore dhe Ujitjen në Shqipëri
Ndryshim

Shkëlqesi,

Në këtë shkresë i referohemi Marrëveshjes së Grantit (Marrëveshja), të datës 30 maj 2013, të lidhur ndërmjet Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (Banka Botërore), në cilësinë e administratorit të fondeve të grantit të ofruara nga Suedia, të përfaqësuar nga Agjencia Suedeze për Zhvillimin dhe Bashkëpunimin Ndërkombëtar (SIDA) (Donatori) dhe Republikës së Shqipërisë (Marrësi). Në përgjigje të shkresës suaj drejtuar Bankës Botërore, më 8 shtator 2015, Banka Botërore propozon ndryshimin e Marrëveshjes si më poshtë:

1. Seksioni 2.02 i aneksit të Marrëveshjes, ndryshon duke hequr fjalët “Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave (MMPAU)” dhe duke i zëvendësuar me “Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave (MBZHRAU)”.

2. Seksionet e mëposhtme në aneksin e Marrëveshjes ndryshojnë duke hequr fjalët “MBUMK” dhe “MMPAU” dhe duke i zëvendësuar me “MBZHRAU”:

- i) Seksioni 2.04 (a) dhe (c);
- ii) Seksioni 2.06 (a);
- iii) Seksioni 2.07 (b) dhe (c);
- iv) Seksioni 2.08 (a) (iii);

3. Tabela në nenin III të aneksit të Marrëveshjes ndryshon si më poshtë:

Kategori	Shuma e Grantit (e shprehur në USD)	Përqindja e shpenzimeve që do të financohen (përfshirë taksat)
1. Mallra (përveç mallrave për pjesën 3(c) të Projektit), shërbime konsulentë, trajnim, shërbime teknike dhe kosto operative rritëse për Projektin	3.536.000.	100%
2. Mallra për pjesën 3 (c) të Projektit	339.000.	55%
TOTALI	3.875.000.	

Për qëllim të këtij seksioni, “Kosto operative rritëse” janë kostot administrative me rritje të arsyeshme graduale të MBZHRAU-së, të shoqëruara me zbatimin e aktiviteteve të projektit, duke përfshirë mirëmbajtjen e zyrave, pajisjet, materialet dhe furnizimet, kostot e komunikimit dhe

kostot e karburantit për vizitat në terren.

Të gjitha dispozitat e tjera të Marrëveshjes, të cilat nuk kanë ndryshuar, mbeten të pandryshuara dhe në fuqi.

Ju lutem, konfirmoni pëlqimin e Marrësit për sa më sipër, duke nënshkruar dhe vendosur datën dhe më pas na e dërgoni kopjen e kësaj shkrese ndryshimi. Kjo shkresë ndryshimi hyn në fuqi nga data në të cilën Banka Botërore i dërgon Marrësit njoftimin e pranimin të saj që ekzekutimi dhe dorëzimi i kësaj shkrese Ndryshimi është autorizuar ose ratifikuar siç duhet me anë të të gjithë hapave të nevojshëm qeveritarë.

Me respekt

BANKA NDËRKOMBËTARE PËR RINDËRTIM DHE ZHVILLIM

Ellen Goldstein

Drejtoreshë për vendin, Evropa Juglindore
Evropa dhe Azia Qendrore

MIRATUAR:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Nga: _____

Përfaqësues i autorizuar

Emri: _____

Titulli: _____

Data: _____